



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 13
24.06.2011

NR. VENDIMI 11
16.11.2011

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e përbërë nga:

GJYQATAR - GURALI BRAHIMLLARI
GJYQTARE - FLORA HAJREDINAJ
GJYQATAR - BARDHYL DHAMA

Asistuar nga sekretare gjyqësore Ermira Tërbuni, në Tiranë, në disa seanca gjyqësore publike, me seancë të fundit, sot në **date 16.11.2011, ora 09.10**, mori në shqyrtim, kërkesën që ju përket palëve:

KERKUES: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda
Xxxxx, Përfaqësuar nga Prokurori A. Xh.

KUNDER: Të paditurit S. G. i biri i V. dhe i Sh. , i datelindjes xx.xx.xxxx,
lindur dhe banues ne Komuna xxxxxxx, Qarku xxxx.

Palë e Tretë: E. G. , i biri i V. dhe i Sh. , i datelindjes
xx.xx.xxxx, lindur dhe banues ne Komuna xxxxxxxx, Qarku xxxx.
Të përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur Xh. M. ,me license me
nr. xxxx e nr. xxxxxxxxxx nipti, avokat i Dhomes se Avokatise
Fier.

OBJEKTI: Konfiskimin e pasurisë të Automjeti tip DAIMLER CHRYSLER ngjyre xxx, vit i prodhimit xxxx, me numer shasie xxxxxxxxxxxxxxx xxxxxx, me targë xx xxxx x, lloji i karburantit xxxx, e blere nga shtetasi E. V. Gj. , sipas kontrates nr. xxxx Rep/ nr.xxxx Kol, date xx.xx.xxxx.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës përfaqësuesi i Prokurorisë pretendoi: Konfiskimin pasurisë së Personit të Tretë **E. V. G.** , Automjetin tip DAIMLER CHRYSLER, ngjyrë xxx, vit i prodhimit xxxx, me numër shasie xxxxxxxxxxxxxxx xxxxxx, me targë xx xxxx x, lloji i karburantit xxxx, e blerë prej tij me kontratës nr.xxxx Rep dhe xxxx Kol, datë 05/06/2007. Për Administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive (*në momentin që do bëhet e mundur gjetja e këtij automjeti*), të ngarkohet **z.E. B.** , i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave - Tiranë, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit - Fier.

Shpenzimet procedurale te kryera deri me tani ne Shumen 55.116,86 (pesëdhjete e pesëmijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë e tetëdhjetë e gjashtë) leke, si dhe shpenzime gjyqesore ti ngarkohen personit te trete E. G.

Mbrojtësi pretendoi se: Rrezimin e kërkesës së organit të prokurorisë duke revokuar masën e sekuestros të venë ndaj automjetit, prone e shtetasit E. G.

Gjykata, si shqyrtoi aktet e fashikullit të prokurorit, provat e paraqitura prej tij dhe si degjoi kërkesën e tij përfundimtare,

VËREN se

Kërkesa e Prokurorit për konfiskimin e pasurisë objket gjykimi, duhet të pranohet sepse u gjend e mbështetur në prova e në ligj.

Nga gjykimi rezultoi se në datën 24.06.2011, në sekretarinë gjyqësore të kësaj gjykate është regjistruar kërkesa e Prokurorisë për Krime të Rënda për konfiskimin e pasurisë së sekuestruar me Vendimin nr.17, datë 30/12/2020, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda – Tiranë.

Nga aktet e provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore, rezulton se në datën 26/04/2010 Prokuroria për Krime të Rënda - Tiranë, ka regjistruar procedimin pasuror nr. 07, në ngarkim të të paditurit **S. V. G. .**, i cili **është ndaluar** nga autoritetet shqiptare në **datën 03/10/2008 dhe aktualisht është duke vujatur dënimin e mësipërm në Institutin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë.** Rezulton se ndonëse është dënuar nga një gjykatë e huaj, vendimi i dënimit të tij është njohur nga gjykat Shqiptare dhe aktualisht konsiderohet se është i dënuar **për një prej veprave penale të parashikuara në nenin 3/1 të ligjit 10192 datë 03.12.2009.**

Në këtë përfundim arrin kjo gjykatë pasi nga provat shkrësore që mori në shqyrtim, u provua në gjykim se Gjykata e Rrethit Gjyqësor - Fier, kundër të paditurit S. G. , ka dhënë Vendimin nr. 405, datë 14/11/2008 sipas të cilit ka vendosur “Njohjen e vendimit penal nr.10685 date 12/11/2004 të Gjykatës së Zakonshme të Milanos - Itali, të dhënë ndaj shtetasit shqiptar S. G. , për efekt ekzekutimit e dënimit me burgim të vendosur me këtë vendim, si dhe konvertimin e dënimit prej 23 (njëzetë e tre) vjetësh burgim, në dënimin prej 15 (pesëmbëdhjete) vjet burgim, sipas nenit 283/2 të Kodit Penal, pa ndryshimet e bëra me ligjin nr.8733 datë 24/01/2001. Ndërsa, Gjykata e Apelit - Vlorë, me Vendimin nr.44, datë 05/03/2009, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor - Fier me objekt “Njohjen e vendimit penal nr.2858, datë 13/06/2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos - Itali, të dhënë ndaj shtetasit shqiptar S. G. ”, si dhe ndryshimin e vendimit, duke e konvertuar dënimin e dhënë nga gjykata e huaj me një dënim prej 10 (dhjetë) vjet burgim **sipas nenit 283/2 të Kodit Penal** (pa ndryshimet e bëra me ligjin nr.8733 date 24/01/2001). Sipas vendimeve të mësipërme gjyqësore provohet se i padituri S. G. , në bashkëpunim dhe me persona të tjerë, nga data 28 Prill 2000 deri në datën 22 Dhjetor 2000 ka trafikuar në shtetin italian sasi të konsiderueshme lënde narkotike të llojit heroinë.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë pretendimin e akuzës se i paditur **S. G. , sipas nenit 3/1 pika « ç »**, të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, **është subjekt i hetimit pasuror** sepse, jo vetëm është i dyshuar, por për më tepër është dënuar për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” e cila parashikohet si e tillë dhe në nenin 283/a të Kodit Penal Shqiptar.

Në bazë të nenit 3/2 të ligjit të sipërcituar si subjekte të këtij ligji janë edhe të afërmit e tij e posacërisht edhe vëllezërit. Nga aktet e sjella për gjykim

rezulton se i dënuar S. G. është vëllai i shtetasit E. V. G. gjë që rrjedh nga *Çertifikata familjare me nr.149 025507, datë 11/05/2010 e shtetasit V. G.*

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se përcaktimi nga akuza si palë në këtë gjykim, me cilësinë e Personit të Tretë të të shtetasit E. V. G. , vëllait të të dënuarit S., është në përputhje me nenin 3/2 të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi ai është subjekt i këtij ligji.

Nga hetimi pasuror i pasurive të të dënuarit S. G. dhe të të afërmeve të tij, ka rezultuar se Personi i Tretë E. G. , ka në pronësi të tij një pasuri të konsiderueshme, tokë bujqësore e ndërtesa- magazina, por meqënëse ato sipas akuzës janë vënë përpara vitit 2000 kur provohet se vëllai i tij S. G. është marrë me veprimtari kriminale të trafikimit të narkotikëve, bazuar në nenin 3 / 4 të ligjit 10192 datë 03.12.2009, këto pasuri nuk janë përfshirë në veprimin e ligjit parandalues.

Gjithashtu, rezulton se Personi i Tretë E. G ka edhe pasurinë e rregjistruar në emrin e tij, pikërisht automjeti, DAIMLER CHRYSLER, ngjyrë xxx, vit i prodhimit xxxx, me numër shasie xxxxxxxxxxxxxxxx xxxxxx, me targë xx xxxxx, lloji i karburantit xxxxxx. Këtë pasuri provohet se ai e ka blerë sipas kontratës nr.xxxxx Rep dhe xxxx Kol, **datë 05/06/2007** në shumën prej 500.000 lekë. Gjykata pranon pretendimin e akuzës se kjo vlerë e mjetit nuk është reale. Në bazë të dokumentacionit të dosjes së automjetit, provohet se vlera e tij mjetit para se të targohej është deklaruar në shumën prej **35.500** (tridhjetë e pesëmijë e pesëqindë) euro, prandaj nuk ka patur asnjë mundësi që blerësi të ketë paguar më pak se kaq për fitimin e kësaj pasurie. Veprimi është bërë fiktiv me vlerë më të ulët në këtë kontratë shitjeje, me qëllim shmangien e pagesës së taksës përkatëse. Nga dokumentet doganore rezulton se jo vetem vlera e deklaruar e ketij mjeti ne momentin e hyrjes ne teritorin e Republikës se Shqipërisë ne 01.06.2007 ka qënë 35 000 euro, por edhe taksa doganore për hyrjen etij ne doganën xxxx, sipas urdhërit të clirimit të kësaj dogane në datën 04.06.2007 ka qënë në shumën **1 054 484 lekë**, pra më shumë se dyfishi I vlerës se deklaruar tek noteri në castin elidhjes së kontratës së shitjes.

Kjo pasuri është **krijuar në vitin 2007**, disa vite pas periudhës kur provohet se vëllai i tij S. G. është përfshirë në veprimtrinë kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike.

Akuza pretendon se nga provat shkresore që paraqiti në këtë gjykim,

rezulton se pronari i kësaj pasurie nuk ka ushtruar ndanjë aktivitet të ligjshëm që të siguronte të ardhura për justifikimin e vlerës prej xx xxxx xxxx të saj. Ky pretendim provohet me Procesverbalin për kqyrjen dhe marrjen e provave materiale datë 20/10/2010, I cili së bashku me gjithë dokumentacionin e mjetit me targë xx xxx x, provon se ky automjet është në pronësi të personit të tretë E. G. ,

Sipas akuzës me provat shkresore që i ka mbledhur që në fazën e hetimit pasuror, rezultron se i dënuari S. G. e familja e tij si dhe vëllai i tij E. G. e bashkëshortja e tij, nuk figurojnë të regjistruar në zyrat e tatim taksave, pra nuk janë të licensuar për ndonjë veprimtari tregtare.

Gjithashtu, nga provat e paraqitura prej akuzës rezulton se Personi i Tretë ka lidhur kontratë shitblerje të pasurive të paluajtëshme, në vitin 2005, pra pas përfshirjes së të dënuarit E. G. në veprimtarinë e kundërligjeshme të “Trafikut të nakotikëve”, por këto pasuri sipas akuzës, vetëm janë formalizuar në këtë periudhë sepse blerja është realizuar në vitete xxxxx-xxxxx dhe nuk i ka përfshirë nën veprimin e ligjit parandalues. Kështu përshëmbull rezulton se është Kontrate shitje te pasurise se palujtshem, nr. xxxx regj, nr. xxx/x Kol, **te dates xx.xx.xxxx**, e cila sipas akuzës, ben fjale per te njejin objekt, që eshte blere më date xx.xx.xxxxx dhe qe eshte fiksuar edhe në këtë kontrate, së bashku me aktet shoqeruese per blerjen e nje magazine.

Në bazë të nenit 21/3 të ligjit parandalues sipas të cilës “ **barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjeshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi**”; në disa séance gjyqësore, Gjykata dëgjoi pretendimet e mbrojtjes dhe provat e paraqitura prej saj për të justifikuar pasurinë.

Ndonëse rezulton se Perosni i Tretë, aktualisht **nuk është i licensuar** për ushtrimin e ndonjë aktiviteti tregëtar, Gjykata erdhi në dijeni se ai ka statusin e subjektit passive, ka qënë i regjistruar më pare në organet tatimore. Kështu nga përgjigjen me nr. 16778/1Prot, datë 29/12/2010, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, sipas së cilës rezulton se: **z.E. G., figuron i regjistruar** në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, me **status Pasiv** me NIPT xxxxxxxxxx x, me aktivitet xxx xxxxx me adresë Lagja: ”xxxxx x xxxxxx”,si dhe shkresën me nr. nr.15205/1 Prot, datë 29/12/2010 e QKR-Tirane, së cilës rezulton se; Shtetasi **E. G.**, i biri i V. , i datëlindjes 1968, **figuron të jetë i regjistruar në Regjistrin Tregtar** me vendimin nr.631, datë 16/09/2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si person fizik me fushë veprimtarie

“xxx-xxxx”, por **nuk është i pajisur me xxxx (xxxx)**. Në bazë të ligjit për QKR, subjektet që janë të regjistruar me vendim Gjykate, por të pa pajisur me NIPT, **do të konsiderohen të c’regjistruar.**

Në bazë të nenit 21/3 të ligjit parandalues, të sipërcituar ishte detyrë e mbrojtësit dhe personalisht e Personit të Tretë, që të paraqiste prova lidhur me këtë aktivitet posaçërisht përpara periudhës së vënies së pasurisë objket konfiskimi, pra para datës 05.06.2007.

Gjykata vlerëson se nga provat shkresore dhe ato me dëshmitarë që paraqiti mbrojtje gjatë këtij gjykimi, nuk arriti të provojë ligjshmërinë e vlerës së kësaj pasurie sepse nuk mundi të justifikojë të ardhurat për blerjen mjetit prej xx xxxx xxxx.

Kështu mbrojtja paraqiti dëshmitarët *N. N. dhe F. B. të cilët dëshmuan rrethanat se si* personi i tretë E. G. , gjatë periudhës 1993-1994, ka shkuar e punuar si emigrant, *në mënyrë ilegale*, në shtetin grek ku ka punuar, së bashku me ta, kryesisht në sektorin e ndërtimit. Pra, ata dëshmuan se E. G. ka punuar vetëm për rreth një vit në Greqi e poas kësaj ka ardhur në fshatin e tij në Dermenas Fier ku ka pasur një aktivitet tregëtar si xxx-xxxx.

Ndërsa dëshmitari Selim Genica dëshmoi se punëdhënësi i tij, E. G. , “pasi ka ardhur nga Greqia ka blere disa dyqane ne fshat. Ka blere nje xxxxxxxx xxxxxxxxxx, nje xxxxxxxx xxxxxxxxxx dhe nje xxx xxxx. Ai i ka blere te treja keto xxxxxxxx ne fshatin xxxxxxxx. Keto i ka blere me parate qe solli nga Greqia.”

Gjykata vlerëson se këto deklaratime nuk mund të merren ne konsiderat nëse nuk paraqiten prova shkresore nga ana e Personit të Tretë, për pasurinë e të cilit kërkohet të veprohet.

Pretendimi i mbrojtjes në konkluzione përfundimtare se Personi i Tretë ka pasur mjete lluksoze edhe me perpara ne perdorim madje se edhe ka shitur nje oprej tyre perpara blerjes se mjetit objket gjykim, nuk rezuklton e provuar ne gjykim sepse mbrojtja nuk paraqiti asnje prove per kete pretendim.

Ndërsa lidhur me të ardhurat e krijuara në emigracion, Gjykata vlerëson se ndonëse nga mbrojtja nuk u paraqit ndonjë dokument apo provë shkresore për të vërtetuar punësimin e tij, si dhe pagën që ka marë, përsëri të ardhurat që dëshmitarët treguan se mund të ketë krijuar Personi i Tretë E. G. ne vitin 1994-1995 si emigrant në Greqi, janë konsumuar shumë kohë përpara periudhës

nga koha kur është blerë mjete objekt konfiskimi, pra nuk ka pasur asnjë mundësi që ato të radhura për krijimin e kësaj pasurie.

Ndryshe nga sa pretendoi mbrojtja, Gjykata vlerëson se në periudhën përpara vitit 2007 personi i Tretë E. G. , nuk ka pasur aktivitet të ligjshëm për krijimin e të ardhurave që të justifikonte blerjen e këtij mjete llogaritur për kushte e vendin e banimit të tij. Ai ka qënë i papunë dhe se deri në vitin 2008, nuk rezulton se ka kryer ndonjë aktivitet të ligjshëm tregëtar. Pretendimi i mbrojtjes që me dëshmtarin S. G. mund të provohet aktiviteti tregëtar i ushtruar nga E. G. në fshatin Dermenas në lokalitetin xxx-xxxx, nuk mund të merret në konsideratë. Nga provat shkresore rezulton se ai ka paguar në Komunë detyrime vetëm në periudhën 2009 e në vijim, pra pas vitit 2007 kur është blerë pasuria objekt konfiskimi.

Edhe kontrata e qeraje e pasurisë së palujtshme me nr. xxxx rep, nr. xxxx Kol në vlerën 10 mijë lekë në muaj është lidhur në datën 21.10.2008, pra të ardhurat e siguruar nga kjo qera janë pas vitit 2007 kur ai e kishte blerë mjete objekt konfiskimi. Sipas kësaj kontrate, provohet se janë krijuar të ardhura, në shumën prej 10 mijë lekë në muaj pas datës 21/10/2008. Por, pavarësisht faktit se me këto të ardhura të familjes së personit të tretë E. G. janë minimale, sërish konkludojmë se janë pas periudhës në të cilën është blerë automjeti objekt kërkese për konfiskim (pas datës 05/06/2007).

Prava shkresore e paraqitur nga mbrojtja, Vertetim date 26.10.2011 leshuar nga Albpetrol sha.a, rezulton se Personi i Tretë E. G. është punonjës në sektorin e nxjerrjes së gazit, por ai ka filluar punë më datë 12/05/2009 dhe se ka një pagë prej 65.400 lekë në muaj.

Kurse pjesëtarët e tjerë të familjes G. nuk rezultojnë që të jenë të punësuar.

Pra në tërësi mbrojtja nuk provoi se Pala e Tretë E. G. në periudhën përpara momentit të krijimit të pasurisë objekt konfiskimi, pra deri në datën 05.06.2007, kishte burime dhe mundësi financiare për të blerë e mbajtur në përdorim një automjet me vlerë 35 000 euro.

Në këto kushte gjykata vlerëson se kjo pasuri është rrjedhojë e veprimtarisë së paligjësghme të ushtruar nga i dënuari S. G. , vëllai i tij, në fushën e lëndëve narkotike dhe duhet të konfiskohet.

Gjykata sqaron se pasuria objekt konfiskimi është vjedhur pas dhënies së vendimit për sekeustrimin e saj. Për këtë nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier është rregjistruar një procedim penal i cili, sipas shkresës nr.

5106/1 Prot, datë 23.09.2011 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht është i pezulluar, si dhe autori i kryerjes së veprës penale akoma nuk është identifikuar.

Megjithatë Gjykatat vlerëson se, për shkakun e mësipërm, veprimi i ligjit parandalues mbi pasurinë objekt konfiskimi, nuk mund të pushojë së vepruari. Nëse ky vendim merr formë të prerë ai vihet në ekzekutim në çdo moment që pasuria gjendet fizikisht ose autiro i vjedhjes zbulohet dhe ai detyrohet të kthejë sendin e vjedhur ose vlerën e tij prej 35 000 euro plus taksat e paguara nga subjekti cdoganues.

Si përfundim, nga shqyrtimi gjyqësor rezulton se i dënuari S. G., personi i tretë E. G. si dhe familjarët e tyre, nuk disponojnë të ardhura të ligjshme që të justifikojnë blerjen e automjetit objekt konfiskimi, prandaj gjykata vlerëson se kjo pasuri e pajustificuar duhet të jetë krijuar si rezultat i aktivitetit të paligjshëm në fushën e trafikimit të narkotikëve të të dënuarit S. G. e për rrjedhojë, në bazë të nenit 24/1 të ligjit 10192 datë 03.12.2009, duhet të konfiskohet.

PER KETO ARSYE

Sa më sipër, Gjykata, në mbështetje të neneve 3, 21, 22, 24, të Ligjit nr.10192 datë 03/12/2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, si dhe në nenin 306 e vijues të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës. Konfiskimin e pasurisë së Personit të Tretë **E. V. G.**, Automjetin tip DAIMLER CHRYSLER, ngjyrë xxx, vit i prodhimit xxxx, me numër shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxx, me targë xx xxxx x, lloji i karburantit xxxx, e blerë prej tij me kontratës nr.xxxx Rep dhe xxxx Kol, datë 05/06/2007.

- Për Administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive (*në momentin që do bëhet e mundur gjetja e këtij automjeti*), të ngarkohet **z.E. B.**, i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave - Tiranë, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarrimit - Fier.

- Shpenzimet procedurale te kryera deri me tani ne shumen shumen 55.116,86 (pesëdhjete e pesëmijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë e tetëdhjetë e gjashtë) leke, si dhe shpenzime gjyqesore ti ngarkohen personit te trete E. G.

Kundër vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda brenda afatit ligjor.

U shpall ne Tiranë, me date 16.11.2011, ora 09.45.

SEKRETARE

GJYQTARI

Ermira TËRBUNI

Gurali BRAHIMLLARI

